REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. 01
Org Jedinica
Org Unit
Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -45-
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot.No: 05-7669
Data:
Datum:
Date: 29/10/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit– Ured Ministra –Office of the Minister

Nr: 242 /X/2026
Datë: 28.10.2026

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në nenin 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. Rregullores (QRK) - nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, duke u bazuar në nenet 15, 18 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2023 për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Udhërrëfyesi Klinik "Menaxhimi i Dermatozave Ekzematoze dhe Alergjike".

II. Zbatimi i Udhërrëfyesi Klinik është i detyrueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë.

III. Udhëheqësit e institucioneve shëndetësore janë përgjegjës për sigurimin e zbatimit të Udhërrëfyesi Klinik.

IV. Udhërrëfyesi Klinik publikohet në faqen zyrtare të MSh dhe të IKSHPK.

V. Shtojcë e këtij vendimi është Udhërrëfyesi Klinik "Menaxhimi i Dermatozave Ekzematoze dhe Alergjike".

VI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vitia
Minister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:
- *Zëvendësministrave;*

- *Sekretarit i Përgjithshëm;*
- *KKUPK-së;*
- *SHSKUK-së;*
- *Div. KPSH;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Departamentit të PSSh;*
- *Arkivit të MSh-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

MENAXHIMI I DERMATOZAVE EKZEMATOZE DHE ALERGJIKE

UDHËRRËFYES KLINIK

Udhërrëfyesi Nr.10/2025 Prishtinë, 2025 Verzioni 1.0

Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokole klinike:

MSc. Niman Bardhi, PhD. – Kryesues

Znj. Fatbardhe Murtezi – Anëtare

Dr. Shaban Osmanaj – Anëtar

Z. Mentor Sadiku – Anëtar

Dr. Teuta Qilerxhiu – Anëtare

Dr. Fakete Hoxha - Anëtare

Prof. Dr. Premtim Rashiti – Anëtar

Dr. Lauras Idrizi – Anëtar

Z. Agron Bytyqi – Anëtar

Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së adaptimit të udhërrëfyesve klinik:

Prof. Dr. Merita Berisha – Kryesuese

Dr. Drita Lumi – Anëtare

Prof. Dr. Valbona Zhjeqi – Anëtare

Dr. Merita Vuthaj – Anëtare

Mr. Sci. Ariana Qerimi – Anëtare

Grupi punues:

Dr. Nazife Hajdini-Ahmetaj – Kryesuese

Dr. Fëllanza Ismajli-Hoxha – Anëtare

Dr.Sci. Reihane Bislimi-Berisha – Anëtare

Ass.Dr. Artina Pajaziti – Anëtare

Dr. Vjollca Zeqiri – Anëtare

Mr.Ph. Arbenita Pajaziti – Anëtare

Përmbajtja

I.HYRJE 5
II. QËLLIMI DHE FOKUSI 5
III. PËRKUFIZIMET 6
IV. TË DHËNAT EPIDEMIOLOGJIKE 8
V. POPULLATA E CAKUT 8
VI. AUDIENCA E CAKUT - DEDIKIMI 8
VII. PYETJET KLINIKE 9
VIII. METODOLOGJIA DHE PROCESI I ADAPTIMIT 10
8.1 Rishikimi i jashtëm dhe procesi i adaptimit 12
8.2 Metodologjia e gradimit të rekomandimeve dhe cilësia e evidencave shkencore 12
8.3 Rekomandimet 13
IX. PLANI PËR REVIDIMIN DHE PËRDITËSIMIN E UDHËRRËFYESIT 14
X. VLERËSIMI 14
XI. DIAGNOSTIKIMI I URTIKARISË KRONIKE SPONTANE (UKS) 16
11.1. Algoritmi diagnostik i pacientëve që prezentojnë me urtika dhe/ose angioedema për më shumë se 6 javë: 16
XII. Konfirmimi i UKS dhe përjashtimi i diagnozave diferenciale 17
XIII. Identifikimi i gjendjeve relevante që mund ta modifikojnë aktivitetin e sëmundjes 17
XIV. Menaxhimi i dermatozave alergjike 18
XV. Menaxhimi i dermatozave ekzematoze 18
15.1 Diagnostikimi i dermatozave ekzematoze 18
15.2 Hapat për menaxhimin klinik 21
15.2.1 Hapi 1: Marrja e historisë/ Anamneza 21
15.2.2 Hapi i 2 është ekzaminimi fizik i pacientit 22
15.2.3 Hapi 3 dhe 4 22
XVI. EKZEMA E PIODERMIZUAR 23
16.1 Menaxhimi 23
16.2 Trajtimi 23
16.3 Kujdesi dhe mirëmbajtja e lëkurës ekzematose 24
XVII. REKOMANDIMET 24
XVIII. Menaxhimi dhe trajtimi i formave të ashpërsuara të ekzemës 26

18.1 Kortikosteroidet 26
18.2 Larjet 28
IXX. INFEKSIONET EKZEMATOZE TË LËKURËS 29
19.1 Infeksionet bakteriale 29
19.2 Infeksionet virale 29
19.3 Infeksionet e përsëritura 29
19.4 Rekomandimet 29
XX. KORTIKOSTEROIDET 30
20.1 Rekomandimet 32
XXI. IMUNOMODULATORET TOPIKALE (TACROLIMUS DHE PIMECROLIMUS) 33
XXII. TERAPIA ANTIPRURITIKE 35
XXIII. ANTIHISTAMINIKËT 35
XXIV. FOTOTERAPIA 35
24.1 Rekomandimet 36
XXV. Agjentët imunosupresues 36
25.1 Ciklosporina 36
25.2 Rekomandimet 36
XXVI. PROCESI I ADAPTIMIT TË UDHËRRËFYESIT 38
XXVII. APLIKIMI DHE ZBATIMI I UK NË RRETHANA TONA 39
SHKURTESA DHE DEFINICIONE 40
REFERENCAT 41

I.HYRJE

Dermatozat alergjike dhe ekzematoze janë përfaqësuese të një game të gjerë të reaksioneve alergjike të lëkurës, që ndikojnë në shëndetin dhe cilësinë e jetës së individëve në nivel global. Hartimi i udhërrëfyesit klinik për këto problematika përfshin:

1. Nevojën për të ofruar kujdes cilësor dhe të standardizuar për pacientët me dermatoza alergjike dhe ekzematoze,
2. Përmirësimin e diagnostikimit dhe menaxhimit të dermatozave alergjike dhe ekzematoze përmes kritereve të diagnostikimit e vlerësimit të rrezikut,
3. Zvogëlimin e variabilitetit në trajtim të dermatozave alergjike dhe ekzematoze,
4. Parandalimin e komplikimeve dhe rritjen e sigurisë: udhëzime për identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe përparimin e parandalimit të komplikimeve të mundshme të këtyre gjendjeve, duke përfshirë reaksione të rënda alergjike dhe infeksionet e lëkurës. Ky parandalim i komplikimeve ndihmon edhe në zvogëlimin e kostove të kujdesit shëndetësor.

Ky udhërrëfyes mbulon definimin dhe klasifikimin e dermatozave alergjike dhe ekzematoze, duke marrë në konsideratë progresin e fundit për menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, këtu përshkruhen qasjet diagnostike dhe terapeutike të bazuara në evidencë për nën-llojet e ndryshme të klasifikimeve bazë.

II. QËLLIMI DHE FOKUSI

Ky udhërrëfyes synon t'i shërbejë çdo institucioni shëndetësor dhe të gjithë profesionistëve shëndetësor.

Qëllimi i këtij udhërrëfyesi klinik është menaxhimi dhe trajtimi i bazuar në dëshmi, në mënyrë që të minimizohen dhe shmangen efektet nga trajtimet eventuale joadekuate të dermatozave alergjike dhe ekzematoze. Përmes unifikimit të trajtimit gjatë menaxhimit të pacientëve me këto patologji, synojmë përmbushjen e kërkesave të pacientëve dhe kosto-efektivitetin e shërbimeve të ofruara.

Të dhënat e ofruara në këtë dokument paraqesin informacionet e pesë-vjeçarit të fundit në lidhje me menaxhimin optimal të dermatozave alergjike dhe dermatozave ekzematoze. Ky udhërrëfyes klinik i dedikohet specialistëve të dermatologjisë, pediatrisë; specialistëve mjekë familjar, mjekëve të përgjithshëm dhe të gjithë specialistëve që kujdesen për pacientët me këto gjendje. Të lartëcekurit pritet ta zbatojnë këtë UK.

III. PËRKUFIZIMET

Urtikaria paraqet një grup të sëmundjeve, që karakterizohen me zhvillimin e urtikave, angioedemës, ose të të dyjave. [1,2] Urtikaria duhet të diferencohet nga gjendjet e tjera, në të cilat urtikat, angioedema ose të dyja mund të shfaqen, psh: anafilaksa, sindromet autoinflamatore, vaskuliti urtikarial ose angioedema e ndërmjetësuar nga bradikinina, duke përfshirë angioedemën hereditare.

Urtika ka tri tipare tipike:

Edemën qartë të kufizuar nga lëkura e shëndoshë, me variacione në formë dhe madhësi;

Ndjenjën e kruarjes ose ndonjëherë djegies;

Natyrën tranzitore: lëkura kthehet në gjendjen paraprake brenda 30 min – 24 orëve.

Angioedema karakterizohet nga:

- Edema e menjëhershme, e theksuar, eritematoze ose ngjyrë lëkure, e thellë, në dermisin retikular, subkutis ose membranë mukozale;
- Ndjenja e djegies, tensionit dhe ndonjëherë dhimbjes, më tepër se e kruarjes;
- Shërimi më i ngadalshëm se i urtikave (mund të zgjasë deri në 72 orë).

Spektri i manifestimeve klinike të urtikarive të ndryshme dhe nëntipeve është shumë i gjerë. Për më tepër, dy ose më shumë nëntipe të urtikarisë mund të koekzistojnë në të njëjtin pacient.

Urtikaria klasifikohet në:

Urtikari akute ose kronike, bazuar në kohëzgjatje. Urtikaria akute definohet si shfaqje e urtikave, angioedemës ose të dyjave për 6 ose më pak orë. Urtikaria kronike definohet si prezencë e urtikave, angioedemës ose të dyjave për më shumë se 6 javë. Urtikaria kronike mund të shfaqet çdo ditë ose në kurse intermitente. Urtikaria kronike mund të rishfaqet muaj ose vite pas remisionit komplet.

Sipas nxitësve: jane urtikari të nxitura ose spontane. Urtikaria e nxitur karakterizohet nga shfaqja e urtikave, angioedemës ose të të dyjave pas nxitjes specifike.

Këtu bëjnë pjesë:

- **Dermografizmi simptomatik;**
- **Urtikaria nga të ftohtit;**
- **Urtikaria nga presioni i zgjatur;**
- **Urtikaria solare;**
- **Urtikaria e nxehtësisë;**
- **Angioedema vibratore;**
- **Urtikaria kolinergjike;**
- **Urtikaria e kontaktit;**
- **Urtikaria akuagjenike.**

Dermatozat ekzematoze i referohen grupit të sëmundjeve inflamatore të lëkurës, që përfshijnë 20-30% të tërë patologjisë dermatologjike. [3,5,6,7,8]Karakterizohen nga tipare klinike të ngjashme, duke përfshirë skuqjen, puprrat, fëshikëzat, lëngëzimin, luspimin, lihenifikimin dhe ndjenjën subjektive të kruarjes, me intensitet të ndryshëm. Në shfaqjen e këtyre dermatozave, rol luan ndërveprimi kompleks i faktorëve gjenetikë, imunologjikë dhe mjedisorë. Në këtë grup përshihen:

Dermatiti atopik: paraqet sëmundje inflamatore, pruritike, kronike ose me relapse, që shfaqet shpesh në familjet me sëmundje të tjera atopike (astma bronhiale dhe/ose rinokonjuktiviti alergjik).

Ekzema seborroike: paraqet pezmatim të regjioneve seborroike. Veçori kryesore ka skuqjen dhe luspimin.

Ekzema diskoide: formë e dermatitit kronik pruritik, që paraqitet me vatra të përbëra nga papula dhe vezikula të grupuara në bazë eritematoze, me lokalizim kryesisht në gjymtyrë.

Ekzema dishidrotike: formë e vecantë e ekzemës, që karakterizohet me erupsion të kohëpaskohshëm të fshikëzave në pjesët anësore të gishtave, shuplakave dhe të shputave.

Dermatiti lihenoid: formë e dermatitit ekzematoz, që paraqitet pas fërkimit dhe kruarjes së vazhdueshme të një sipërfaqeje të lokalizuar të lëkurës.

Dermatiti lihenoid linear: dermatozë e rrallë, me formë lineare karakteristike që përcjell linjat Blaschko.

Ekzema varikoze: paraqet inflamacion kronik të lëkurës, kryesisht në pjesën e poshtme të kërcinjve me varikozitete.

Dermatiti toksik i konktaktit: reaksion inflamator joimunologjik i lëkurës që zhvillohet pas kontaktit me ndonjë lëndë ngacmuese të përqëndruar.

Dermatiti alergjik i kontaktit: reaksion inflamator imunologjik, i tipit të vonshëm, pas kontaktit të ripërsëritur me lëndën alergjene, te personat e predisponuar.

Ekzema asteatotike: çrregullim që manifestohet me lëkurë të thatë dhe me plasaritje, sidomos te të moshuarit.

Fotodermatiti i kontaktit: paraqet reaksion inflamator të lëkurës që paraqitet pas ndërveprimit të lëndëve të ndryshme kimike fotosensibilizuese (faktorët ekzogjenë) dhe dritës ultravjollcë.

IV. TË DHËNAT EPIDEMIOLOGJIKE

Urtikaria është një sëmundje e shpeshtë, forma akute paraqitet me prevalencë 20%, ndërsa forma kronike 0.8%. Urtikaria kronike spontane dhe format e tjera kronike të urtikarisë ndërhyjnë në cilësinë e jetës dhe ndikojnë në përformancën në punë dhe në shkollë.

Dermatiti atopik (DA) është një prej sëmundjeve më të shpeshta të lëkurës, që prek deri në 20% të fëmijëve dhe 1-3 % të të rriturve në shumicën e shteteve botërore. DA është shpeshherë hapi i parë në zhvillimin e sëmundjeve të tjera atopike si riniti dhe/ose astma.

Prevalenca e dermatitit të kontaktit është më e vështirë për tu përcaktuar, por studimet sugjerojnë se ajo mund të jetë rreth 1-3% në popullsinë e përgjithshme.

V. POPULLATA E CAKUT

Popullatë e cakut në këtë udhërrëfyes janë pacientët e të dy gjinive, të të gjitha grupmoshave (nga foshnjet deri te të rriturit e moshuar), me të gjitha format e shfaqjes klinike (akute, kronike), me dhe pa komorbiditet.

VI. AUDIENCA E CAKUT - DEDIKIMI

Udhërrëfyesi klinik i dedikohet profesionistëve shëndetësorë, në të tri nivelet e sistemit shëndetsor, të cilët merren me menaxhimin dhe trajtimin klinik të pacientëve me dermatoza alergjike dhe ekzematoze, specialistëve të dermatologjisë, pediatrisë, specialistëve mjekë familjarë, mjekëve të përgjithshëm dhe të gjithë specialistëve që kujdesen për pacientët me dermatoza alergjike dhe ekzematoze. Të njëjtët pritet të zbatojnë këtë UK.

Burimet njerëzore të nevojshme për zbatimin e udhërrëfyesit klinik janë profesionistët shëndetësorë për trajtimin e pacientëve të dyshuar dhe të konfirmuar me diagnozat e sipërpërmendura.

Pas aprovimit të Udhërrëfyesit klinik, GP do të vazhdojë me hartimin e Protokoleve Klinike për të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, me qëllim të definimit të përgjegjësive në trajtimin dhe menaxhimin e dermatozave alergjike dhe ekzematoze.

VII. PYETJET KLINIKE

Grupi për adaptimin e Udhërrëfyesit (GAU), bazuar në rishikimin e literaturës në dispozicion, duke përfshirë udhërrëfyesit e OBSH-së dhe udhëzime të tjera zhvilloi qëllimin dhe fokusimin e udhërrëfyesit. Në takimin e radhës GAU ka rënë dakord mbi pyetjet shëndetësore prioritare të kërkimit, të cilat janë më të aplikueshme në praktikën tonë klinike, duke përdorur formatin popullatë, ndërhyrje, krahasim, rezultat (PICO).

Këto pyetje i përgjigjen:

1. Ndërhyrjeve farmakologjike për ofrimin e kujdesit klinik të menjëhershëm; si dhe

2. Ekzaminimeve plotësuese laboratorike dhe diagnostike.

Më poshtë janë të renditura pyetjet shëndetësore, të cilat përfshijnë:

- **Cila është qasja diagnostike tek pacientët me urtika dhe/ose angioedema?**
- **Cilat janë analizat laboratorike që duhet t'ju kërkohen pacientëve me urtikari kronike spontane (UKS) ?**
- **Cila është qasja diagnostike tek pacientët me urtika dhe/ose angioedema për më shumë se 6 javë?**
- **Cilët janë faktorët indetifikues relevant në gjendjen e sëmundjes?**
- **Cila është skema e menaxhimit dhe trajtimit të urtikarive spontane kronike (UKS)?**
- **Cilat janë kriteret për diagnostikimin e dermatozave ekzematoze?**
- **Cilat janë hapat për menaxhimin klinik dhe parimet për ofrimin e trajtimit te pacientët me dermatoza ekzematoze?**
- **Çka paraqet SCORAD –Indexi te dermatiti atopik?**
- **Cili është menaxhimi dhe trajtimi i formave të ashpërsuara të ekzemës ?**
- **Çka është Finger-tip Unit (FTU)?**

Duke i përdorur këto pyetje, ne kemi përpiluar udhërrefyesin klinik për menaxhimin e dermatozave ekzematoze dhe alergjike.

VIII. METODOLOGJIA DHE PROCESI I ADAPTIMIT

Ky udhërrëfyes është hartuar nga grupi punues multidisiplinar dhe multiprofesional i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës.

Të gjithë anëtarët e Grupit për Adaptimin e Udhërrëfyesit (GAU) përpara angazhimit në procesin e hartimit të këtij udhërrëfyesi kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë konflikt interesi, për çka edhe kanë nënshkruar deklaratat e konflikit të interesit.

Ky udhërrëfyes është hartuar në përputhje me metodologjinë standarde të procesit të adaptimit të udhërrëfyesve duke u shërbyer me dokumentin AGREE II. Në fazën përgatitore të procesit, i kemi ndarë detyrat sipas prioriteteve dhe përgaditjes profesionale të secilit anëtarë të grupit. Disa prej anëtarëve të grupit kanë qenë të trajnuar për adaptimin e UK-së.

Në fazën e dytë të procesit, gjatë kërkimit nëpër udhërrëfyesit e lartpërmendur, kemi vlerësuar cilësinë e udhërrëfyesit të cilin e kemi marrë për adaptim, aktualitetin, përmbajtjen dhe mundësinë e aplikimit të rekomandimeve në vendin tonë.

Marrja e vendimeve dhe rekomandimeve nga anëtarët e grupit punues është bërë me konsensus të plotë të të gjithë anëtarëve. Për çdo pyetje klinike të gjithë anëtarët e grupit kanë qenë dakord unanimisht. Të gjithë anatarët e grupit kanë përpiluar pyetje klinike të cilat do të ju shërbejnë profesionistëve shëndetësor. Për çdo pyetje kritike të parazgjedhur, evidencat janë marrë nga rishikimet sistematike ekzistuese në literaturën e përzgjedhur dhe janë të bazuara në rekomandime të forta. Për pyetjet mbi politikat dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor, evidenca përshkruese është përmbledhur, me pikat e forta dhe të dobëta të qasjeve të ndryshme të identifikuara.

GAU ka rishikuar udhërrëfyesit klinik të publikuar në vitet e fundit, me rekomandime të qëndrueshme dhe me shkallë të evidencave.

Fjalët kyçe gjatë kërkimit kanë qenë:

"udhërrëfyes", "ekzema" "urtikaria", "angioedema", "alergji".

Udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna në udhërrëfyesin klinik janë bazuar në literaturën ndërkombëtare si dhe përshkrimi i rekomandimeve është bërë sipas literaturës së përzgjedhur. Një ndër kriteret kryesore për t'u përcaktuar për adaptimin e UK ishin pyetjet shëndetësore më të aplikueshme në praktikën tonë klinike.

Aplikueshmërinë e pyetjeve klinike e kemi testuar përmes formatit PICO me ç'rast kanë rezultuar edhe pyetjet të cilat janë më të aplikueshme në praktikën tonë të përditshme.

Janë shqyrtuar disa udhërrëfyes klinik dhe përfundimisht grupi punues është përcaktuar për udhërrëfyesit në vijim:

Global Reports on Atopic Dermatitis 2022, nga International League of Dermatological Societies (ILDS) global-report-on-atopic-dermatitis-2022.pdf (eczemacouncil.org);

Udhërrefyesi Europian dypjesësh për menaxhimin e dermatitit atopik: Guidelines for treatment of atopic eczema (atopic dermatitis) Part I - Ring - 2012 - Journal of the European Academy of Dermatology and Venereology - Wiley Online Library; Guidelines for treatment of atopic eczema (atopic dermatitis) Part II - Ring - 2012 - Journal of the European Academy of Dermatology and Venereology - Wiley Online Library;

Consensus-based European guidelines for treatment of atopic eczema (atopic dermatitis) in adults and children: part I - Wollenberg - 2018 - Journal of the European Academy of Dermatology and Venereology - Wiley Online Library;

Consensus-based European guidelines for treatment of atopic eczema (atopic dermatitis) in adults and children: part II - Wollenberg - 2018 - Journal of the European Academy of Dermatology and Venereology - Wiley Online Library.

The international EAACI/GA²LEN/EuroGuiDerm/APAACI guideline for the definition, classification, diagnosis, and management of urticaria. Allergy. 2022 Mar;77(3):734-766. doi: 10.1111/all.15090. Epub 2021 Oct 20. PMID: 34536239.

Me qëllim të kërkimit të literaturës së bazuar në evidencë, kemi përdorur platformat Scopus, Pubmed dhe Cochrane përmes fjalëve kyçe: eczema, atopic eczema, atopic dermatitis. Është shfrytëzuar kryesisht literatura e publikuar në revistat shkencore të dëshmuara, me impakt faktor të lartë dhe kritere tjera të relevancës shkencore.

Udhërrefyesi kyç në të cilin bazohemi dhe mbështetemi, kryesisht bazohet në standardet europiane Appraisal of Guidelines Research and Evaluation. Procesi i koncenzusit përbëhet nga një grup nominal dhe procedura DELPHI. Konferencat e koncenzusit janë mbajtur në Berlin (Tetor 2009), Cavtat (Maj 2010), Munich (Korrik 2010) dhe Goteborg (Tetor 2010). Në to janë formuar grupet për këtë udhërrefyes. Përpara publikimit të këtij udhërrefyesi europian, sipas standardeve EDF, të gjitha shoqatat europiane të dermatologjisë janë ftuar të japin mendimet dhe qëndrimet në lidhje me udhërrefyesin e përbashkët të propozuar. Gradat e evidencës së përdorur kanë qenë: metaanalizat e RCT, RCT si të vetme, rishikimet e literaturës së hulumtimeve klinike, studimet kohorte, rishikimet e literaturës së rasteve case-control dhe studimet e vetme case-control, renditur sipas relevancës së tyre.

Duke pasur parasysh mënyrën e përpilimit të këtij udhërrëfyesi, dhe faktit që përkon me temën e udhërrëfyesit tonë, duke u bazuar në faktin që për dermatozat ekzematoze ende nuk është përpiluar një udhërrëfyes më i përditësuar në nivel europian dhe botëror, arsyetojmë përdorimin e kësaj literature. Rekomandimet konkrete për menaxhimin e dermatozave ekzematoze janë

adaptuar për vendin tonë. Udhërrëfyesi i miratuar do të shpërndahet dhe prezentohet te të gjithë profesionistët shëndetësorë, të cilët bazuar në kompetencat e tyre të përcaktuara do ta bëjnë zbatimin e tij.

Grupi punues do të jetë i gatshëm për sqarime të përmbajtjes së dokumentit për të gjithë profesionistët shëndetësorë të përfshirë në menaxhimin e dermatozave ekzematoze dhe alergjike. Rishqyrtimi i udhërrëfyesit klinik do të bëhet prap sipas nevojës, varësisht nga zhvillimet e fundit në menaxhim, me verzionin vijues.

Udhërrefyesi klinik "Menaxhimi i dermatozave ekzematoze dhe alergjike" është i përpiluar nga grupi punues i përberë nga profesionistë shëndetësorë të fushës së dermatovenerologjisë, përvoja e të cilëve lidhet ngushtë me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve me dermatoza ekzematoze dhe alergjike. Në grup janë përfshirë edhe profesionistë tjerë specialistë mjek familjar dhe mjek farmakolog, për të siguruar zbatimin e metodologjisë për hartimin e këtyre dokumenteve si dhe procesit të përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Janë siguruar literaturat e nevojshme për përpilimin e udhërrëfyesit, duke u bazuar në përditësimet që janë bërë në nivel europian dhe botëror në lidhje me temën.

8.1 Rishikimi i jashtëm dhe procesi i adaptimit

Grupi për adaptimin e Udhërrëfyesit Klinik "Menaxhimi i dermatozave ekzematoze dhe alergjike" ka propozuar komisionin recenzues në përbërje: 1.Sci.Dr. Merita Kotori, Specialist-e e Dermatovenerologjisë, SHSKUK dhe 2.Sci.Dr. Fatime Kokollari, Specialist-e e Dermatovenerologjisë, SHSKUK (shih Shtojcën 2). Rekomandimet dhe udhëzimet e recenzentëve janë integruar në këtë UK.

Drafti final është publikuar në web faqe të Ministrisë së Shëndetësisë ku është dhënë mundësia e komentimit publik nga të gjitha grupet e interesit si dhe të gjithë shfrytëzuesit e udhërrëfyesit. Informatat kthyese dhe komentet janë analizuar dhe janë përfshirë në draft final të dokumentit. Gjithashtu drafti është pilotuar nga 3 deri 4 pacientë nga të cilët nuk ka pas komente.

8.2 Metodologjia e gradimit të rekomandimeve dhe cilësia e evidencave shkencore

Evidencat shkencore për rekomandimet u analizuan duke përdorur Gradimin e Vlerësimit të Rekomandimeve, Zhvillimit dhe Evaluimit (GRADE) për hulumtim klinik. (Grading of Recommendations Assessment, Development and Evaluation (GRADE) methodology for the clinical interventions).

Për hulumtim klinik, cilësia e evidencave mbështetëse u vlerësua si shumë e ulët, e ulët, e moderuar ose e lartë, duke përdorur metodologjinë GRADE, bazuar në grupin e mëposhtëm të kritereve të paracaktuara:

Tabela 1. Cilësia e evidencës mbështetëse sipas metodologjisë GRADE

Niveli i evidencës	
E Lartë	Të dhënat nga meta-analizat e derivuara nga shumë hulumtime klinike të randomizuara. Ka konsistencë në rezultatet e studimeve dhe nuk ka dallime të mëdha midis tyre. Evidenca është e qartë dhe e drejtpërdrejtë në lidhje me rezultatet e pritura.
E Moderuar	Të dhënat e derivuara nga një hulumtim klinik i randomizuar ose studime të gjëra të pa randomizuara. Ka nevojë për një sërë studimesh të tjera për të rritur sigurinë në vlerësimin e rezultateve.
E Ulët	Konsensus i pikëpamjeve të ekspertëve dhe/ose studime të vogla, studime retrospektive. Ekzistojnë dyshime ose moskonsistencë në rezultatet e studimeve.
Shumë e Ulët	Studimet e rasteve Evidenca është shumë e kufizuar dhe nuk ka besueshmëri. Mund të ketë probleme serioze metodologjike në shumicën e studimeve.

Sipas metodologjisë së përdorur si më sipër, fortësia e rekomandimeve shënohet me shkronja të mëdha (A, B, C), ndërsa cilësia e dëshmive, e cila mbështet rekomandimin përkatës shënohet me numra latin dhe shkronja të vogla (I, IIa, IIb, III).

Tabela 2. Gradimi i cilësisë së dëshmive për rekomandime

1a	Metaanaliza të RCT
1b	RCT të vetme
2a	Rishikime sistematike të studimeve kohorte
2b	Studime kohorte të vetme dhe RCT të kualitetit të limituar
3a	Rishikime sistematike dhe studime rast-kontrollë
3b	Studimet të vetme rast-kontrollë
4	Raste serike, studimet rast-kontrollë ose studime kohorte të kualitetit të limituar

8.3 Rekomandimet

Çdo rekomandim i përfshirë në këtë udhërrëfyes përfshin një drejtim (në favor ose kundër) dhe një vlerësim të shkallës së forcës. Kategoritë e mëposhtme janë përdorur për të vendosur vlerësimin e fuqisë së një rekomandimi:

- rekomandim i fortë do të thotë se ka besim se efektet e dëshirueshme të respektimit të një rekomandimi tejkalojnë efektet e padëshirueshme;
- rekomandimi i kushtëzuar do të thotë që efektet e dëshirueshme të respektimit të një rekomandimi ndoshta i tejkalojnë efektet e padëshiruara, por nuk ka besim të plotë për këtë konkluzion.

IX. PLANI PËR REVIDIMIN DHE PËRDITËSIMIN E UDHËRRËFYESIT

Përditësimi i këtij udhërrëfyesi do të bëhet pas tre deri në pesë-vite. Procedura e revidimit përcaktohet nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa UK përditësohet në bazë të dëshmive të fundit të publikuara, kërkesave dhe rekomandimeve nga përdoruesit e UK.

Tabela 3. Klasifikimi i fortësisë së rekomandimeve

Fortësia e rekomandimit	Grada e evidencës
A	1a, 1b
B	2a, 2b, 3a, 3b
C	4
D	Mendimi i ekspertit

X. VLERËSIMI

Historia e detajuar është hapi i parë esencial në diagnostikimin e urtikarisë te të gjitha format. Hapi i dytë është ekzaminimi fizik i pacientit. Meqenëse urtikat dhe angioedema janë tranziente dhe mund të mos jenë prezente në kohën e ekzaminimit fizik, [9-13] është e rëndësishme të kërkohet për dokumentim të shenjave (duke përfshirë edhe fotografitë e urtikave/angioedemës). Hapi i tretë, në diagnostikimin e urtikarisë akute është hulumtimi laboratorik bazik, me teste të limituara (shiko tabelën me testet bazike të rekomanduara). Hulumtime të tjera individuale diagnostike mund të jenë të nevojshme, bazuar në rezultatet e hapit të tretë, dhe duke u varur nga lloji dhe nënlloji i urtikarisë (shiko tabelën). **Këta hapa udhëzues i përgjigjen pyetjes së 1-rë në lidhje me udhëzimin e personelit shëndetësor në lidhje me qasjen ndaj pacientit, për të cilin dyshojmë se ka urtika/ angioedemë.** Qëllimi i cilitdo test laboratorik të kerkuar duhet të jetë i qartë për mjekun ordinues.

Tabela 4. Testet laboratorike të nevojshme për urtikari/angioedemë

Lloji	Nënlloji	Testet diagnostike rutinë të rekomanduara	Programi i zgjeruar diagnostik (bazuar në të dhënat anamnestike) për identifikimin e shkakut bazë ose faktorëve nxitës dhe për të përjashtuar diagnoza diferenciale sipas indikacionit
Urtikaria spontane	Urtikaria spontane akute	Asnjë	Asnjë
	Urtikaria spontane kronike	Hemogram, SE dhe/ose CRP	Shmangia e nxitësve të dyshuar (psh. medikamenteve); testet diagnostike (pa ndonjë rregull në renditje): për sëmundje infektive (psh. H.Pylori), autoantitrupat funksional (psh testi i bazofileve), çrregullimet e gjëndrrës tiroide, alergji, sëmundje sistemike, të tjera.
		IgG- anti-TPO dhe IgE totale	
Urtikaria e nxitur	Urtikaria nga të ftohtit	Provokimi me të ftohtë	Pasqyra e gjakut dhe SE ose CRP, për të përjashtuar sëmundjet tjera, sidomos infeksionet
	Urtikaria e presionit të zgjatur	Testet e presionit	Asnjë
	Urtikaria e të nxehtit	Provokimi me të nxehtë	Asnjë
	Urtikaria solare	Ekspozimi në rrezatim UV dhe dritë të dukshme të gjatësive valore të ndryshme	Përjashto dermatozat e tjera të nxitura nga drita
	Dermografizmi simptomatik		
	Angioedema vibratore	Testi me vibrim	
	Urtikaria akuagjenike	Provokimi	
	Urtikaria kolinergjike	Provokimi	
	Urtikaria e kontaktit	Testi i provokimit	

Në këtë tabelë është dhënë përgjigja pyetjes së 10, në lidhje me kriteret diagnostike të formave të ndryshme të urtikarive.

XI. DIAGNOSTIKIMI I URTIKARISË KRONIKE SPONTANE (UKS)

Në UKS, hulumtimi laboratorik ka 7 qëllime kryesore: konfirmimi i diagnozës dhe përjashtimi i diagnozave diferenciale; hulumtimi i shkakut; identifikimi i gjendjeve relevante që modifikojnë aktivitetin e sëmundjes; hulumtimi i komorbiditeteve, identifikimi i pasojave të UKS, përcaktimi i dekursit të sëmundjes dhe reagimit në terapi,si dhe monitorimi i aktivitetit të sëmundjes, ndikimit dhe kontrollës.[14] Në të gjithë pacientët me UKS duhet të realizohen testet laboratorike: pasqyra e gjakut, CRP dhe/ose SE, dhe IgE totale e IgG-anti-TPO te pacientët nën kujdesin specialistik. Bazuar në rezultate nga këto masa, teste të tjera laboratorike kerkohen sipas indikacionit. **Të dhënat e mësipërme shërbejnë si përgjigje ndaj pyetjes së 2-të, në lidhje me analizat laboratorike që duhet t'u realizohen pacientëve me UKS.**

11.1. Algoritmi diagnostik i pacientëve që prezentojnë me urtika dhe/ose angioedema për më shumë se 6 javë:

1. Përpos ACE inhibitorëve, sartanet, gliptina dhe neprilizinë-inhibitorët janë përshkuar më rrallë si nxitës të angioedemës;
2. Pacientëve duhet t'ju merret historia e detajuar e familjes dhe mosha e fillimit të sëmundjes;
3. Testet për markerë inflamatorë të rritur (CRP, SE), testi për paraproteinemi te të rriturit, kërko për infiltrate të pasura me neutrofile në biopsi të lëkurës.
4. Pacientët duhet pyetur: "Sa gjatë qëndron një urtikë individuale?"
5. Testet për C4 komplementin, C1-INH nivelet dhe funksionin. C1q dh C1-INH antitrupat, nëse dyshohet te angioedema e fituar për shkak të deficiencs së C1-inhibitorit.
6. Remisioni duhet të vërehet brenda disa ditësh, në raste të rralla deri në 6 muaj pas ndërprerjes së ACE inhibitorit.
7. A tregon biopsia lezionale dëmtim të enëve të vogla të gjakut në dermisin papullar dhe retikular dhe/ose depozita fibrinoide në lokalizime perivaskulare dhe intersticiale, sugjestive për vaskulitin urtikarial?
8. Pacientët duhet pyetur: "A mund t'i nxitni urtikat të shfaqen?"
9. Te pacientët me histori sugjestive të urtikarisë së nxitur, duhet të performohen testet standarde të provokimit.
10. Në disa raste, angioedema nuk ndërmjetësohet as nga mastocitet, as nga bradikinina, dhe mekanizmi patofiziologjik mbetet i panjohur. Atyre rasteve i referohemi si angioedemë idiopatike sipas disa autorëve.

Në paragrafin e mësipërm gjendet përgjigja e pyetjes së 3-të, në lidhje me qasjen diagnostike ndaj pacientëve me urtika dhe/ose angioedema për më shumë se 6 javë.

Tabela 5. Ekzaminimi i përgjithshëm dhe monitorimi i pacientit me UKS

Historia Ekzaminimi fizik Testet bazike	
Konfirmimi	Përjashtimi i diagnozave diferenciale
Shkaku	Kërkoni për indikatorë të UKS,
Ko-faktorët	Identifikoni nxitësit potencial/agravuesit
Komorbiditetet	Për shembull hulumtoni për autoimunitete, shëndet mendor
Pasojat	Identifikoni problemet me gjumë, stres, shëndet seksual, punë, performancë sociale
Komponentet	Qasuni biomarkerëve potencialë ose reagimit në terapi
Dekursi	Monitoroni aktivitetin dhe impaktin e UKS

XII. Konfirmimi i UKS dhe përjashtimi i diagnozave diferenciale

Urtikat ose angioedemat shfaqen te pacientët te shoqeruar edhe me sëmundje të tjera. Pacientët që zhvillojnë vetëm urtika, por jo edhe angioedema, si vaskuliti urtikarial dhe çrregullimet autoinflamatore si Sy. Schnitzler ose sindroma e asocuar me kriopirinë (CAPS) duhet të përjashtohen. [15-19] Ndërsa, tek pacientët që zhvillojnë vetëm angioedemë rekurente, por jo urtika, angioedema e ndërmjetësuar nga bradikinina dhe angioedema hereditare duhet të përjashtohen nga diagnoza diferenciale.

XIII. Identifikimi i gjendjeve relevante që mund ta modifikojnë aktivitetin e sëmundjes

Identifikimi i gjendjeve relevante që mund të modifikojnë aktivitetin e sëmundjes dhe faktorët ekzacerbues si medikamentet, ushqimi, stresi dhe infeksionet mund të ndihmojnë mjekët dhe pacientët të kuptojnë dhe ndonjëherë të ndërrojnë rrjedhën e UKS. Medikamentet mund të ekzacerbojnë gjendjen, më së shpeshti prej tyre NSAID. Duhet të kërkohet informacion në lidhje me marrjen e NSAID, dhe të këshillohet mënjanimi i tyre, për të parandaluar ekzacerbimin. Testi i provokimit është i panevojshëm. **Ky paragraf i përgjigjet pyetjes së 4-të në lidhje me identifikimin e gjendjeve relevante që mund ta modifikojnë aktivitetin e sëmundjes.**

XIV. Menaxhimi i dermatozave alergjike

Rekomandimet për menaxhimin e dermatozave alergjike sugjerojnë përdorimin e antihistaminikëve të gjeneratës së dytë në dozë 10mg/d (p.sh.: Loratadine tab), ose antihistaminikë ekuivalentë, për 1 javë.

Në rast të persistimit të gjendjes, rekomandohet të kalohet në hapin tjetër:10mg (2 doza të ndara ditore) antihistaminikë i gjeneratës së dytë ose antihistaminikë ekuivalentë, për 2-4 javë.

Në rast të persistimit të gjendjes, rekomandohet të kalohet në hapin tjetër:20mg (2 doza të ndara ditore) antihistaminikë i gjeneratës së dytë ose antihistaminikë ekuivalentë, për 2-4 javë.

Rekomandimet e mësipërme i përgjigjen pyetjes së 5-të në lidhje me menaxhimin e urtikarive kronike spontane (UKS).

XV. Menaxhimi i dermatozave ekzematoze

15.1 Diagnostikimi i dermatozave ekzematoze

Diagnostikimi i dermatozave ekzematoze në radhë të parë është klinik dhe bazohet në veçoritë anamnestike, morfologjinë dhe shpërndarjen e lezioneve të lëkurës dhe shenjat klinike shoqëruese. [20]

Nuk ekziston ndonjë kriter i veçantë laboratorik, histologjik apo klinik me të cilin do të diagnostikoheshin dermatozat ekzematoze. Hanifin dhe Rajka në vitin 1980 kanë përcaktuar kriteret me të cilat mund të konstatohet dermatiti atopik dhe të diferencohet nga llojet e tjera të ekzemës. Ato janë 4 kritere majore dhe 23 kritere minore. Për të caktuar diagnozën e dermatitit atopik, duhet të përmbushen 3 kritere majore dhe 3 kritere minore.

- **Kriteret majore** (nevojiten 3 ose më shumë) janë:
  - Pruritus (kruarja)
  - Morfologjia dhe shpërndarja tipike:

-shpërndarja në faqe dhe në pjesët ekstensore te motakët,

- likenifikimet flexurale te fëmijët dhe të rriturit.

  - Ecuria kronike e sëmundjes (remisionet dhe egzacerbimet);
  - Historia personale apo familjare për atopi (astma, riniti alergjik, dermatiti atopik).

- **Kriteret minore** (nevojiten 3 ose më shumë)
  - Lëkura e thatë (kseroza);
  - Iktioza /hiperlineariteti palmar/ keratosis pilaris;
  - Tejndjeshmëria e tipit të hershëm (tip I);

- Rritja e nivelit të IgE në serum;
- Fillimi i hershëm i sëmundjes (nga muaji 3 pas lindjes);
- Tendenca për infeksione të lëkurës (imuniteti qelizor i afektuar);
- Dermatiti joalergjik i shuplakave/shputave;
- Dermatiti i thimthave;
- Keiliti;
- Konjunktiviti rekurent;
- Rrudhat infraorbitale të Dennie-Morgan – it;
- Keratokonusi;
- Katarakta subkapsulare e përparme;
- Hiperpigmentimi periorbital;
- Skuqja/zbehja e fytyrës;
- Pitiriaza e bardhë;
- Rrudhat në pjesën e përparme të qafës;
- Kruarja pas djersitjes;
- Intoleranca ndaj leshit;
- Theksimi perifolikular;
- Intoleranca në ushqime;
- Ecuria e sëmundjes nën ndikimin e faktorëve emocionalë dhe të mjedisit;
- Dermografizmi i bardhë.

Ekzistojnë edhe kritere të tjera për diagnostikim. Kështu, në vitin 1990, hulumtuesit në Britani të Madhe, për të diagnostikuar dermatitin atopik kanë përcaktuar kruarjen dhe 3 nga kriteret e tjera të poshtëshënuara:

- Të dhënat për reliev të theksuar të lëkurës (rrudhat në qafë, në bërryla, në gjunjë);
- Lëkura e thatë në tërë sipërfaqen gjatë 2 viteve të fundit;
- Paraqitja e simptomave te fëmijët para moshës 2 vjeçare;
- Paraqitja e dermatitit në sipërfaqet flexurale (lakesat).

Të dhënat e mësipërme japin shpjegime në lidhje me kriteret diagnostikuese të dermatozave ekzematoze, duke dhënë kështu përgjigje në pyetjen e 6-të.

Rekomandimi për diagnozën e dermatozave ekzematoze tregohet në tabelën II, dhe forca e rekomandimit është shfaqur në tabelën III. Shpesh është e vështirë të diferencohet dermatiti ekzematoid nga dermatiti seborroik në foshnjëri, dhe të dy gjendjet mund të mbivendosen në këtë grupmoshë. Dermatiti ekzematoid zakonisht kursen regjionet axillare, ndërsa dermatiti seborroik ndikon në këto zona dhe ka tendencë të mos jetë pruritik, veçanërisht nëse nuk i përgjigjet terapisë. [21-26]

Tabela 6 - Rekomandimi për diagnozën e DA

Pacientët me dermatit a diagnostikohen bazuar në kriteret e përmbledhura minore dhe majore.

Në disa raste , mostrat e biopsisë së lëkurës ose testet e tjera (të tilla si immunoglobulina E në serum, PATCH testimi) mund të jenë të dobishme për të përjashtuar problem të tjera në lidhje me lëkurën.




Tabela 7 - Klasifikimi i fortësisë së rekomandimeve për diagnozën dhe menaxhimin e DA

Rekomandimet	Fortësia e rekomandimit	Grada e evidencës
Diagnoza bazuar ne kriteret major dhe minor	C	III
Asnjë biomarker specifik për diagnozën apo vlerësimin DE	B	II
Testet e imunoglobulinës E nuk rekomandohen në mënyrë rutinore	A	I
Shkalla e ashpërsisë së sëmundjeve në dispozicion jo për përdorim klinik rutinë	C	I
Stili i jetës	C	II
Duhet të pyesni për kruarjen, gjumë, aktivitetet e përditshëme,dhe persistimi i semundjes	C	III
Ndërgjegjësimi dhe diskutimi me shoqata të përbashkëta	C	I dhe II
Qasje e integruar dhe multidisiplinare ndaj kujdesit	C	III

Tabela 8 - Rekomandimet për shfrytëzimin e biomarkerëve dhe menaxhimin e DA

Nuk ekziston ndonjë marker specifik që rekomandohet për diagnostikimin dhe vlerësimin e sëmundjeve ekzematoze.
Monitorimi i niveleve të imunoglobulinës E nuk është i rekomanduar për vlerësimin rutinë të akutizimit të sëmundjes ekzematoze.

Diagnoza e dermatozave ekzematoze mbetet klinike, sepse aktualisht nuk ka biomarker të besueshëm që mund të dallojë sëmundjen nga entitetet e tjera.

15.2 Hapat për menaxhimin klinik

	Hapat për menaxhimin klinik
Hapi 1	Marrja e historisë
Hapi 2	Ekzaminimi fizik
Hapi 3	Hulutimet laboratorike bazike
Hapi 4	Testet in vivo me shpim të lëkurës **testet patch (SPT) dhe testet in vitro IgE.**
Hapi 5	Ofrimi i trajtimit

15.2.1 Hapi 1: Marrja e historisë/ Anamneza

Rishikimi i literaturës të OBSH-së synon t'i përgjigjet pyetjes numër 7 , që flet për hapat lidhur me menaxhimin klinik dhe parimet për ofrimin e trajtimit te pacientët me dermatoza ekzematoze?

• Marrja e historisë së detajuar është hapi i parë esencial në diagnostikimin e dermatozave ekzematoze;

• Fillimi, lloji dhe ashpërsia e ekzemës;

• Te foshnjat <18 muajshe, më shpesh preken faqet, skalpi dhe sipërfaqet ekstensore;

• Te fëmijët më të rritur, ekzema zakonisht shfaqet si dermatit fleksural p.sh. fossa cubiti, fossae poplitea, qafa, kyçit të këmbës, zona periorbitale;

• Simptoma të shoqëruara, p.sh. reduktim i gjumit, kruajtje, nervozizëm, ushqyerje e dobët;

• Shkaktarë të identifikuar;

• Trajtimet aktuale dhe të mëparshme të ekzemës, duke përfshirë frekuencën e trajtimeve, vëllimin e kremave të përdorur, manipulimin dietik, trajtimet plotësuese;

• Infeksionet e mëparshme të lëkurës p.sh. Staph. aureus, varicella, zoster, virusi herpes simplex;

• Histori personale dhe familjare të atopisë;

• Ndikimi i ekzemës në cilësinë e jetës së fëmijës dhe familjes, p.sh. numri i ditëve të mungesës në shkollë/punë, numri i ditëve të hospitalizimit;

• Diare të vazhdueshme dhe/ose infeksione të përsëritura (konsideroni mungesën e imunitetit, mungesën e mikronutrientëve). [27]

15.2.2 Hapi i 2 është ekzaminimi fizik i pacientit

Ekzaminimi

- Lloji dhe shpeshtësia e trajtimeve të ekzemës varet nga ashpërsia e ekzemës dhe prania/mungesa e infeksionit.

Tabela 9. Format e ekzemes

Forma	Lëkurë normale, nuk ka dëshmi të ekzemës atopike aktive.
E lehtë	Zonat me lëkurë të thatë, kruarje të rrallë (me ose pa zona të vogla skuqjeje).
E moderuar	Zonat me lëkurë të thatë, kruarje të shpeshtë, skuqje (me ose pa eksfolim dhe trashje të lokalizuar të lëkurës).
E rëndë	Zona të përhapura të lëkurës së thatë, kruarje të vazhdueshme, skuqje (me ose pa eksfolim , hiperkeratozë e lëkurës, gjakderdhje, lëngzim, plasaritje dhe hipopigmentime post-inflamatore).

15.2.3 Hapi 3 dhe 4

Në diagnostikimin e dermatozave ekzematoze është bazik hulumtimi laboratorik, si dhe identifikimi me anë të testeve in vivo, testet e shpimit të lëkurës **PATCH testet (SPT)** dhe testet in vitro [28] (serumi **IgE specifike**). Përveç kësaj, **PATCH testet** rezultuan të jenë të dobishme për të studiuar përgjigjet e vonuara të lëkurës të lidhura me ushqimin.

Për më tepër, **IgE specifike** in vitro ndaj alergjeneve ushqimore japin të dhëna sasiore më të mira për shkallën e sensibilizimit. Kjo ndihmon për të vlerësuar probabilitetin e rrezikut të një reaksioni klinik.

Për të vlerësuar aktivitetin e sëmundjes shfrytëzohet i ashtuquajturi **SCORAD – Index** (**S**everity **S**coring of **A**topic **D**ermatitis). Ky sistem i vlerësimit mbështetet në 6 shenja klinike: eritema, krustat, ekskoriacionet, luspimi, plasaritjet dhe likenifikimi. Vlerësimi bëhet në 6 regjione të trupit: koka dhe qafa, trupi, shuplakat, shputat, duart dhe këmbët, duke përdorur shkallëzimin me vlerat prej 0 deri 3 (0 – nuk ka shenja; 1 – lehtë; 2 – relativisht; 3 – tepër). Një metodë e tillë e vlerësimit është treguar e suksesshme gjatë hulumtimeve epidemiologjike në përcjelljen e efektit

terapeutik gjatë aplikimit të protokoleve të ndryshme të mjekimit, por edhe në mjekimin e përditshëm të të sëmurëve me dermatoza ekzematoze.

Paragrafi i mësipërm shërben si përgjigje për pyetjen Nr. 8-të, në lidhje me shfrytëzimin e SCORAD –Indexit për përcaktimin e shkallës së ashpërsisë te dermatiti ekzematoid.

Dermatozat ekzematoze paraqesin sëmundje kronike inflamatore të lëkurës, të karakterizuara me lëkurë të thatë dhe pruritike.

• Ekzema prek 30% të fëmijëve, dhe shpesh zhvillohet para moshës 12 muajshe.

• Shpërndarja, ashpërsia dhe acarimi i shkaktuar nga ekzema mund të përkeqësohet në mënyrë akute, kjo quhet akutizim i ekzemës.

• Edukimi i kujdestarëve për ekzemën dhe menaxhimin e saj është kyç në reduktimin e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së shpërthimeve të ekzemës.

XVI. EKZEMA E PIODERMIZUAR

- Veçoritë klinike topikale: përfshijnë intensifikim të pruritit, efloreshenca vezikulare, satelitore, pustulare, erozive, të buta, me kore ose të qara në lëkurën ekzematoze.
- Veçoritë sistemike: përfshijnë temperaturën e rritur trupore dhe gjendje të rënduar të përgjithshme.

16.1 Menaxhimi

- Testet laboratorike zakonisht nuk janë të nevojshme;
